



# Përkrahja juaj dhe Edukimi

Letër informative - ekskluzive për përkrahësit  
e Fondit Kosovaro Amerikan për Edukim (KAEF)

## Sakrificat e juaja për studentët Në kohërat e krizës globale, përkrahja juaj i jep prioritet edukimit

Që nga fillimi i krizës globale në nëntor të vitit 2008, përkrahësit si ju dhanë shumë më e \$300,000 për ta përkrahur Fondin Kosovaro Amerikan për Edukim, duke demonstruar kështu devotshmërinë tuaj ndaj edukimit. Zemërgjërësia juaj vjen në mes të krizës globale, në kohën kur nivelet globale të përkrahjeve uleshin vazhdimisht.

“Për shumë programe përreth botës, donatorët janë duke dhënë me pak”, thotë William Brown, zëvendës kryetar për zhvillim. “Ajo çka është më interesante, është fakti se përkrahja ndaj KAEF-it është rritur. Kjo tregon se donatorët e kuptojnë se ardhmëria e Kosovës varet nga edukimi”.

Përkrahja juaj është treguar të jetë thelbësore për suksesin e KAEF-it. Përderisa shumë programe që ofrojnë bursa janë detyruar të zvogëlojnë numrin e bursistëve, KAEF-i në të kundërtën, për herë të parë në historinë e tij, është zgjeruar në vitin 2009 duke ndarë nëntë bursa.

Nga viti 2005, zemërgjërësia e juaj ka ndihmuar që të ndahen 48 bursa për liderët e rinj kosovarë. Bursistët që e kanë kryer programin janë kthyer në Kosovë dhe veprojnë për ta zhvilluar shtetin e tyre.

Me përmirësimin e ekonomisë, donacionet e juaja do të luajnë rol jetësor për KAEF-in, dhe nëpërmjet KAEF-it, ky rol do të jetë jetësor edhe për Kosovën.

## A e keni parë??

Ju mund ta shihni reklamën e re të KAEF-it, “Thyerja e Barrierave,” të bërë nga Entermedia, në:

[www.support-kaef.org](http://www.support-kaef.org)

Gjithashtu në ueb faqe:

- Shikoni intervistat me të diplomuarit e programit
- Mësoni se si programi punon për të mirën e të gjithë kosovarëve



*Njoftobuni me shtatë nga bursistët e KAEF-it për vitin 2010, të mbështetur nga përkrahja juaj. Duke filluar nga e majta: Shkëlqim Daci, Jeta Krasniqi, Arben Limani, Agon Maliqi, Mentor Mehmedi, Emira Ajeti dhe Besian Mustafa. Pa përkrahjen tuaj, këta bursistë nuk do të kishin mundur të merrnin pjesë në programin KAEF.*

## KAEF ndan nëntë bursa në natën e gostisë

### Përkrahja juaj e zgjeron programin në numrin më të madh deri më tani

Me përkrahjen tuaj bujare, Fondi Kosovaro Amerikan për Edukim zyrtarisht i ndau bursat për nëntë bursistë në një gosti të mbajtur në Prishtinë, Kosovë, të premtën me datën 28 maj 2010. Stafi i KAEF-it zyrtarisht i prezantoi edhe shtatë bursistët që morrën pjesë në gosti, por gjithashtu edhe nëntëmbëdhjetë bizneset kosovare që e kanë përkrahur programin. Ministri i Arsimit, iu bashkëngjiti të ftuarve në gosti për t'i përzgjedhur bursistët dhe gjithashtu për t'i falenderuar përkrahësit.

Përkrahja juaj bujare do t'i mbështet studentët në vijim, në vitin që vjen: **Emira Ajeti** (Master në Administrim të Biznesit), **Shkëlqim Daci** (Planifikim Urban), **Jeta Krasniqi** (Ekonomi dhe Politika Publike), **Arben Limani** (Studim mbi Ligjiin Ndërkombëtar), **Agon Maliqi** (Politika Publike), **Mentor Mehmedi** (Financa Publike), dhe **Besian Mustafa** (Master në Administrim të Biznesit). Liridon Mavriqi dhe Vatra Qehaja gjithashtu ishin fitues të bursës së KAEF-it, mirëpo ata nuk e pranuan bursën për shkaqe personale dhe profesionale.

**AMERICAN COUNCILS** FOR INTERNATIONAL EDUCATION  
ACTRAACELS

[www.support-kaef.org](http://www.support-kaef.org)

# Hapet konkursi për aplikim në KAEF për vitin 2011

Ju mund të ndihmoni në shpërndarjen e lajmit!

Aplikimi për KAEF për vitin 2011 tanimë është i hapur. Ju mund ta ndihmoni KAEF-in duke e shpërndarë lajmin tek miqtë, familjarët, punëtorët, kolegët dhe persona të tjerë në rrejet tuaj. Data e fundit për aplikim është 6 shtatori. Kandidatët duhet të shpenzojnë kohë të konsiderueshme gjatë përgatitjes së aplikacionit, ku përfshihen edhe esetë dhe rekomandimet. Aplikantët mund të shkojnë në ueb faqen në vijim që ta fillojnë aplikacionin:

[http://www.kaef-online.org/fellowship.php?page\\_id=10](http://www.kaef-online.org/fellowship.php?page_id=10)

Nëse kishit dashur ta keni broshurën elektronike për ta shpërndarë, ju lutemi kontaktoni Nathan Truitt:

[ntruitt@americancouncils.org](mailto:ntruitt@americancouncils.org)

**“Për çdo mijëra të thata në gjetet e vyshkura, qëndron një goditje në rrënjë.” - H.D. Thoreau**

Varfëria, papunësia, dhe korrupsioni shkaktojnë vuajtje të papërshkrueshme për mijëra kosovarë. Me përkrahjen tuaj, Fondi Kosovaro Amerikan për Edukim merr për cak shkaqet rrënjësore të këtyre problemeve. Përkrahja e juaj KAEF-it, sjell eksperiencë jetësore të kualitetit të lartë liderëve të rinj kosovarë. Kontributet tuaja janë duke krijuar një lidhje të rinisë, të talentuar, informuar, përkushtuar, me mundësi për ta ndryshuar Kosovën për të mirë.

Përkrahja juaj e vazhdueshme është jetësore. Ju lutemi konsideroni donacione shtesë për KAEF-in në njërin nga mënyrat në vazhdim.

- Ju mund të kontribuoni online në [www.support-kaef.org](http://www.support-kaef.org)
- Ju mund të bëni transfere në llogarinë bankare të KAEF-it në Kosovë: Numri i llogarisë është: 150 115 0000 071 656 RAIFFEISEN BANK KOSOVA (American Councils for International Education – Kosova)
- Donatorët nga SHBA-ja mund të dërgojnë çek (të drejtuar tek “American Councils”, administratorët e KAEF-it) në: 1828 L Street, NË, Suite 1200; Washington, DC 20036

## Ju faleminderit, donatorë!



*Bursist i KAEF-it, Selim Selimi, buzëqesh dhe pranon urimet nga sbokët e klasës duke ecur drejt mbajtjes së fjalimit të diplomimit në shkollën Sanford për Politikë Publike të “Univesitetit Duke”. Z. Selimi ishte zgjedhur si folës nga 93 studentë të nivelit master, dhe ka mbajtur fjalimin e tij para 240 studentëve nga 21 shtete, familjet e tyre si dhe profesorët e shkollës Sanford.*

## Bursist i KAEF-it zgjedhet si folës në ceremoninë e diplomimit Selim Selimi nderohet si studenti folës në “Duke”

Një nga bursistët e përkrahur nga ju nëpërmjet donacioneve dhënë KAEF-it, Z. Selim Selimi, është zgjedhur si folës në ceremoninë e diplomimit në shkollën me reputacion të “Duke”, shkollën Sanford të Politikave Publike. Ai është zgjedhur për këtë nder nga 93 student të nivelit master. Me 15 maj, ai iu drejtua 240 studentëve nga 21 shtete, prindërve, si dhe profesorëve të “Duke”.

Duke folur për kohën e tij në SHBA, si dhe për vendlindjen e tij Kosovën, Z. Selimi tha: “Ne mësuam se ndryshimi nuk ka ngjyrë, racë, fe, apo status shoqëror. Ajo arrihet më së miri duke filluar nga poshtë-lart, duke e mobilizuar popullin... Gjatë këtyre dy viteve, ne kishim mundësinë të shohim se pa marrë parasysh në cilën pjesë të botës shtetet tona gjenden, apo pa marrë parasysh sa larg ne jetojmë nga njëri tjetri, të gjithë përballemi me pengesa të ngjajshme në aspektin e zhvillimit dhe uljes së varfërisë... Zhvillimi nuk është brengë lokale apo regionale. Por, është brengë globale që nuk mund të arrihet pa e eliminuar varfërinë”.

Lexoni fjalimin e plotë të Selim Selimit në ueb faqen në vijim:

[http://sanford.duke.edu/news/features/Grad\\_Speech\\_MIDP\\_Class2010.pdf](http://sanford.duke.edu/news/features/Grad_Speech_MIDP_Class2010.pdf)

**A doni që ta pranoni këtë letër informative në e-mail, apo jo?**

Kontakttoni Nathan Truitt, në [ntruitt@americancouncils.org](mailto:ntruitt@americancouncils.org) për ta ndërruar mundësinë e kësaj dërgese.

[www.support-kaef.org](http://www.support-kaef.org)